

Si duhet të aplikojmë për përjashtimin nga tarifatat dhe shpenzimet gjyqësore?

Përjashtimi nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës që gjendet në linkun si më poshtë:
<https://www.drejtesia.gov.al/ndihma-juridike-e-garantuar-nga-shteti/>

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- së bashku me kërkesën për ndihmë juridike detyësore (këshillimi, përfaqësimi dhe mbrojtja para gjykatës;
- bashkëlidhur kërkesëpadisë;
- në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur procesi gjyqësor.


Kërkesa mund të paraqitet nga vetë personi që gëzon këtë të drejtë, por edhe nga një përfaqësues ligjor apo i pajisur me prokurë, ose nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja ose i afërm i shkallës së parë. Ajo paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel. Për më shumë informacion ju mund të vizitoni faqen online të **Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas** në linkun: <https://ndihmajuridike.gov.al/>

Gjithashtu, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka vendosur në dispozicion të publikut një numër të gjelbër pa pagesë **0800 10 10** dhe një sistem online **“Juristi Online”** nga ku mund të kërkontë informacion.



PËRJASHTIMI NGA TARIFAT DHE SHPENZIMET GJYQËSORE

KUSH DHE SI MUND TË PËRFITOJË?



Çfarë është tarifa gjyqësore?

Është një pagesë që palët në një proces gjyqësor kryejnë nëpërmjet administratës gjyqësore në favor të administratës tatimore.

- Tarifa gjyqësore e përgjithshme për paraqitjen e kërkesëpadisë përlogaritet mbi bazën e vlerës së padisë për çështje gjyqësore civile dhe administrative;
- Tarifa gjyqësore shtesë caktohet në rastet kur pala ndërgjyqëse ose përfaqësuesi i saj ka shkaktuar pa shkaqe të arsyeshme vonesa në gjykim e çështjes;
- Tarifa gjyqësore e veçantë caktohet për shqyrtimin e kërkesave të veçanta procedurale gjatë zhvillimit të gjykimit dhe/ose për shërbime të administratës gjyqësore.

Çfarë janë shpenzimet gjyqësore?

Janë shpenzimet e kryera në kuadër të procesit gjyqësor dhe të nevojshme për gjykimin (noterizimi apo lëshimi i dokumentacionit nga institucionet, marrja e dëshmisë nga dëshmitari, shpenzimet për ekspertët, përkthyesit, etj), përveç tarifës gjyqësore.

Çfarë është tarifa për vënien në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit?

Është tarifa që i parapaguhet shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror, për vënien në ekzekutim të një titulli ekzekutiv.

Çfarë është përjashtimi nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore?

Është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.

Kush gëzon të drejtën e përjashtimit nga pagimi i tarifave gjyqësore:

- Çdokush që ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar tarifat dhe shpenzimet gjyqësore apo i përket kategorive si më poshtë:
- viktimave të dhunës në familje;
- viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore;
- viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin;
- fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

➤ personave me aftësi të kufizuara ose të verbrit;

➤ personave me probleme të shëndetit mendor;

➤ personave, të cilët janë përfytyes të skemave të mbrojtjes sociale;

➤ personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent.

Në këtë rast, Ju mund të përfitoni përjashtimin nga:

- pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta;
- pagimi i shpenzimeve gjyqësore;
- detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përbarimor gjyqësor shtetëror.